



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË
TIRANË

NR. 7749 AKTI
Data e regj 02/10/2014

NR. 7810 VENDIMI
Dt e vendimit 29/12/2014

VENDIM
«NË EMËR TË REPUBLIKËS»

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë e përbërë nga:

BERNINA KONDI – GJYQTARE

asistuar nga sekretare gjyqësore Qerime Boduri, përfundoi gjykimin sot më datë 29/12/2014, në seancë gjyqësore me dyer të hapura te ceshtjes administrative Nr. 7749 Rregj dhe date 02.10.2014 me pale ndergjygjese :

PADITES: Shoqëria “**Bankers Petroleum Albania**”, dega e Shoqerise se huaj

Bankers Petroleum Albania LTD, regjistruar rregullisht prane Qendres Kombetare te Regjistrimit me NIPT K43128401L, me seli ne adresen Lagjia “Sheq I madh” Rr: Leonardo Murilando”, godina nr. 37, Fier, Shqiperi perfaqesuar nga Av. Florian Hasko”, me autorizimin e dates 08.10.2014, me karte ID nr. I20614168D.

I PADITURL: Drejtoria Pergjithshme e Doganave, perfaqesuar ne gjykim nga

juristia Ornela Biti me autorizimin e dates 09.10.2014 me nr. Extra prot (**ne mungese ne shpallje**).

Ne prani te avokatures se shtetit, perfaqesuar nga Avokate e shtetit, Juliana

Çoma me me karte ID nr. H45819037K, me karte 93 Avokti, ne baze te urdherit nr. 171 date 15.15.2014.

OBJEKTI 1-Shfuqizimin teresisht te akteve administrative te Drejtorise se Pergjithshme te Doganave (i) Nr. 14151 Prot., date 11.06.2014; dhe (ii) Nr. 20805 Prot., date 05.09.2014 ne zbatim te Ligjit Nr. 61/2013 “Per akcizat ne Republikën e Shqiperise”, i ndryshuar;
2-Saktesimin e te drejtave dhe detyrimeve ndermjet paditesit Bankers Petroleum Albania LTD dhe te paditurit Drejtoria e Pergjithshme e Doganave ne lidhje me detyrimin e pretenduar nga i

padituri per pagesen e akcizes sipas akteve administrative Nr. 14151 Prot., date 11.06.2014 dhe Nr. 20805 Prot., date 05.09.2014;

3-Shfuqizimin teresisht te aktit administrativ te Drejtorise se Pergjithshme te Doganave Nr. 23754/2 Prot, date 13.10.2014 (Revokimi i Autorizimit te Magazines Fiskale ne Prodhim) ne zbatim te Ligjit Nr. 61/2013 "Per akcizat ne Republikën e Shqiperise", i ndryshuar dhe rregullimin e pasojave juridike qe vijne nga ky shfuqizim duke rikthyer palet ne situaten e meparshme, duke i rikthyer/leshuar Paditesit Autorizimin e Magazines Fiskale ne Prodhim;

4-Sigurimi i Padise duke pezulluar zbatimin e akteve administrative Nr. 14151 Prot, date 11.06.2014 dhe Nr. 20805 Prot, date 05.09.2014 te Drejtorise se Pergjithshme te Doganave, si edhe te cdo akti administrativ nxjerre ne zbatim te tij nga vete i padituri apo organet e vartesis dhe mosmarrjen nga ana e te paditurit te asnje veprimi, ose nxjerrje akti, urdhri apo vendimi per caktimin e detyrimeve ne lidhje me akcizen deri ne perfundim te shqyrtimit te padise ne lidhje me saktesimin e te drejtave dhe detyrimeve mes paleve ne gjykim.

Baza ligjore:Neni 16, 17/dh, 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012 "Për

Organizimin dhe Funksonimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative"; Neni 1,2,4 e vijues te ligjit nr. 61/2012 per akcizat ne RSH , i ndryshuar.

Ne perfundim te shqyrtimit gjyqësor, Gjykata, pasi administroi provat shkresore, degjoi perfaqesuesin e paditësit, i cili kërkoi pranimin e padisë sipas objektit, perfaqesuesen e palës së paditur, Drejtoria e Pergjithshme e Doganave ,e cila kërkoi rrezimin e kerkese padise, si te pabazuar ne prova dhe ne ligj, , përfaqësuesja e avokaturës rrëzimin e padisë , shqyrtoi dhe analizoi çeshtjen ne teresi

VËREN

Se paditësi Shoqeria "**Bankers Petroleum Albania LTD**" , ka paraqitur për gjykim nje kerkese-padi, ne dt.'02.10.2014, prane Gjykatës Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me objektin perkatës të vendosur në kërkesë-padi, ndaj palës të paditur Drejtoria e Përgjithshme e Doganave .

Me shortin e datës 03.10.2014, kjo çështje është caktuar për gjykim te ky trup gjykues, i cili pas kryerjes së veprimeve pregtatore në bazë të nenit 25 të ligjit nr.49/2012 ka kaluar çështje në seancën gjyqësore.

Në bazë të neneve 9 të Ligjit nr. 49 të vitit 2012 "Për Organizimin dhe Funksonimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrveshjeve Administrative" çështja administrative me Nr. 3198 Akti bën pjesë në juridiksionin gjyqësor administrativ.

Neni 7 pika a i Ligjit nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe mosmarrveshjeve administrative" citon: **"Gjykatat administrative janë kompetente për mosmarrveshjet që lindin nga aktet administrative individuale, aktet nenligjore normative dhe kontratat administrative publike, të nxjerra gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative nga organi publik"**.

Në bazë të këtij neni Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka kompetencë lëndore për të marrë në shqyrtim dhe për të vendosur në lidhje me kërkesë padinë pasi jemi para një kërkimi që rrjedh nga parashikimi i pikës a të nenit të cituar më lart.

Në bazë të nenit 10 të Ligjit nr. 49 të vitit 2012 "Për Organizimin dhe Funksionimin e e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrveshjeve Administrative" çështja administrative me Nr. 7749 Akti bën pjesë në kompetencë funksionale të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Neni 11, i Ligjit nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe mosmarrveshjeve administrative në pikën 1 të tij citon **"Paditë kundër veprimit administrativ shqyrtohen në gjykatën administrative të shkallës së parë, që përfshinë territorin , në të cilin organi publik ka kryer veprimin administrativ që kundërshtohet"**. Në bazë të këtij neni Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka kompetencë tokësore për të gjykuar këtë çështje.

Gjykata fillimisht brenda afatit pesë ditor ka marrë në shqyrtim një nga kërkimet e parashtruara në kërkesë- padi , kërkimin për marrjen e masës së sigurimit të padisë për të cilin u vendos pranim i kërkesës.

Ne baze te kerkeses se paraqitur nga paditësi per shtimin e objektit te Padise, Gjykata me vendim të ndërmjetëm vendosi pranimin e saj konform neneit 185 të K.PR.Civile dhe gjykimi i çështjes vazhdoi me objektin e paraqitur në kërkesë padi duke shtuar edhe kërkimin si vijon:

"Shfuqizimin teresisht te aktit administrativ te Drejtorise se Pergjithshme te Doganave Nr. 23754/2 Prot., date 13.10.2014 ne zbatim te Ligjit Nr. 61/2013 "Per akcizat ne Republiken e Shqiperise", i ndryshuar dhe rregullimin e pasojave juridike qe vijne nga ky shfuqizim duke rikthyer palet ne situaten e meparshme."

Nga shqyrtimi gjyqësor i provave shkresore të administruara në dosjen gjyqësore rezultuan të provuara faktet si më poshtë:

Bankers Petroleum Albania LTD, eshte dege e shoqerise se huaj Bankers Petroleum Albania Ltd., eshte regjistruar rregullisht ne Regjistrin Tregtar me NIPT K43128401L, me seli ne adresen: Lagjja "Sheq i Madh", Rruga "Leonardo Murialdo", Godina nr. 37, Fier, Shqiperi. Shoqeria operon ne fushen e prodhimit te naftes bruto dhe per nevojat e aktivitetit te saj prodhues furnizohet me solar (gjysme produkt hollues), i cili perdoret si hollues nga Shoqeria gjate operacioneve hidrokarbure ne proceset teknologjike per nxjerrjen nga nentoka (prodhimin) e naftes bruto. Holluesi injektohet tek nafta bruto gjate procesit teknologjik te nxjerrjes nga nentoka dhe perftohet serish e trapezuar ne

produktin perfundimtar nafte bruto e gatshme per rafinim. Shoqeria operon ne baze te Licenses Marreveshje date 07.06.2004 lidhur mes Ministrise se Industrise dhe Energjitikes dhe Albpetrol Sh.a. dhe Marreveshjes Hidrokarbure date 19.06.2004 midis Albpetrol Sh.a. dhe Saxon International Energy Ltd. (sot Bankers Petroleum Albania Ltd.) .Shoqeria eshte pajisur me autorizim per magazine fiskale "prodhimi" me kod fiskal specifik AL03421200340, i cili percakton se regjimi i parashikuar per magazinën eshte (i) ne hyrje: diesel 10 ppm Gazoil 1000 ppm, solar/hollues (gjysme produkt) dhe nafte bruto nga nentoka dhe (ii) ne dalje: diesel 10 ppm dhe Gazoil 1000 ppm per konsum nga proceset teknologjike dhe nafte bruto per eksport ose shitje brenda vendit, ku sipas Shkreses Nr. 7583/1 Prot., date 10.05.2013 te DPD-se jane shtuar edhe produktet energjitike me kod E450 (vajra te renda si lende djegese, solar, mazut) . Gjithashtu, Autorizimi percakton se Gazoili perdoret si hollues per nxjerrjen e naftes bruto.

Ne baze te raportit te analizave ne lidhje me produktin objekt konflikti te Inspektoriatit Qendror Teknik prane Ministrise se Energjise dhe Industrise), sipas Shkreses Nr. 5385/1, date 30.12.2013, holluesi me te cilin furnizohet BPAL "... nuk mund te perdoret si karburant dhe/ose lende djegese e lenget per tregun e brendshem" . Shoqeria importonte deri ne daten 31 mars 2014 lenden Gazoil 1000 ppm te perjashtuar nga detyrimi per akcize . Prej dhjetorit 2013, Shoqeria e siguron holluesin ne formen e produktit te gatshem per perdorim edhe nga tregu i brendshem. Ky hollues perfshihet ne kategorine e E450 te produkteve te akcizes sipas Shtojces Nr. 1 (Mallrat e Tatueshme me Akcize ne Republiken e Shqiperise) te Ligjit per Akcizat.Paditesi e transporton holluesin ne regjim pezullimi te akcizes, nga furnizuesi tek magazina e tij fiskale e prodhimit. Nafta bruto, ku eshte trupezuar holluesi sipas shpjegimeve me siper del nga magazina fiskale e Shoqerise nen regjimin e pezullimit te detyrimeve, me destinacion eksportin ose nje magazine tjeter fiskale, nga ku nafta bruto mund te cohej per rafinim. Kjo nafte bruto perdoret si lende e pare ne rafineri per te perftuar nenprodukte (te certifikuara sipas llojit perkates) te cilat ne castin qe hidhen per konsum ne territor jane te detyruara te paguajne akcize. Deri ne daten 31 mars 2014 importimi nga ana e Shoqerise te nenprodukteve te naftes, sic eshte edhe holluesi pershkruar me siper, ishte i perjashtuar nga akciza ne baze te Nenit 10, paragrafi 3 i Ligjit Nr. 61/2012 "Per akcizat ne Republiken e Shqiperise", i ndryshuar .

Kjo dispozite eshte shfuqizuar me efekt prej dates 1 prill 2014, nga Neni 1 i Ligjit Nr. 180/2013 "Per disa ndryshime dhe shtesa ne Ligjin Nr. 61/2012 "Per akcizat ne Republiken e Shqiperise", te ndryshuar" .

Per shkak te Ndryshimit Ligjor te Akcizes ne Import, sipas Ligjit 180/2013, Paditesi i eshte drejtuar Drejtorise se Pergjithshme te Doganave me nje shkrese Nr. 1275 Prot., date 20.12.2013 me objekt "Perdorimi i holluesit nga Bankers Petroleum Albania Ltd..

Ne pergjigje te Shkreses 1275 te Paditesit, i Padituri pergjigjet me shkresen Nr. 23544/1 Prot., date 23.12.2013, se: "*Holluesi, i perdorur nga BPAL ne proceset hidrokarbure ne magazinën fiskale te prodhimit si lende e pare per trajtimin e*

produktit perfundimtar (nafte bruto), duhet dokumentohet, te regjistrohet dhe te paraqitet ne rakordimet mujore prane degeve doganore mbikqyrese”.

Ne vijim, ne baze te disa shkresave te BPAL ku kerkon nje pergjigje dhe interpretim konkret te Ligjit per Akcizat dhe detyrimet e akcizes ne lidhje me holluesin, DPD me ane te aktit administrativ shkrese Nr. 14151 Prot., date 11.06.2014, duke iu referuar shfuqizimit te Nenit 10, paragrafi 3, germa “dh” me ane te Ligjit 180/2013, shprehet se BPAL ka “... detyrimin per pagesen e akcizes per nenproduktet e naftes (te perftuara nga tregu i brendshem apo importi) te perdorur per nevojat e kerkimit te naftes dhe te venies ne shfrytezim te zonave naftembajtese, pavaresisht nga destinacioni i prodhimit.” (“**Akti Administrativ 14151**”).

Ne shtator 2014 DPD nxjerr aktin administrativ shkresa Nr. 20805 Prot., date 05.09.2014, njoftuar Shoqerise me ane te shkreses Nr. 2299 Prot., date 22.09.2014, duke iu referuar Ndryshimit Ligjor te Akcizes ne Import (“**Akti Administrativ 20805**”) dhe citon per kete qellim Nenin 96/1 te VKM 501, si vijon:

“[Per qellime te ketij vendimi, do te konsiderohen] *pika shitjeje me pakice edhe depozitat e kompanive qe i perdorin keto produkte energjetike per nevoja te furnizimit te automjeteve te tyre apo ushtrimit te aktivitetit*” (pika 2 e Nenit 96/1).

Me tej, DPD, i referohet germes “ç” te paragrafit 3 te Nenit 96/1, i cili parashikon se:

“3. *Automjetet qe kryejne transportin e produkteve te listuara ne aneksin 24, gjate levizjes se tyre duhet te kene:(...)*

c) Per levizjen nga magazina e prodhimit ne pikat e shitjes me pakice - DSHA me detyrim akcize te paguar.”

Si rrjedhim, DPD urdheron me ane te Aktit Administrativ 20805 si vijon:

“... *produktet energjitike sipas aneksit 24 qe i bashkengjitet VKM-se nr. 501 te cilat perdoren nga subjektet e kerkimit te naftes dhe te venies ne shfrytezim te zonave naftembajtese me qellim ushtrimin e aktivitetit te tyre, detyrimisht futen ne magazine fiskale me detyrim akcize te pezulluar dhe ne momentin e perdorimit te tyre me qellim ushtrimin e aktivitetit, perpilohet DASH me detyrimet e paguara te akcizes”.*

Ne baze te Aktit Administrativ 20805, ne daten 23.09.2014, Sektori i Akcizes prane Deges se Doganes Fier, mban nje proces-verbal konstatimi me Nr. 2303 Prot., date 23.09.2014 duke pretenduar se Shoqeria, “**Pergjate periudhes 01.04.2014 deri me dt.23.09.2014 ka shmangur detyrimin e pageses se akcizes per furnizimin me produktin solar (gjysme produkt) hollues...”**

Po ne te njejten dite, Dega e Doganes Fier me ane te shkreses Nr. 2303/1 Prot., date 23.09.2014 “Njoftim per rezultat raport kontrolli” i dergon Shoqerise kopje te Procesverbalit te Konstatimit dhe e njofton se ka 5 dite kohe per te paraqitur me shkrim pretendimet, duke e njoftuar Shoqerine qe ne perfundim te ketij afati “... *dega e doganes Fier do te procedoje me marrjen e vendimit dhe kontabilizimit te borxhit ne baze te nenit 100 te ligjit nr.61/2012 “Per Akcizat ne*

Republiken e Shqiperise". Njoftimi ne fjale i eshte dorezuar Shoqerise me date 26.09.2014.

Pavaresisht afatit 5 ditor qe Dega e Doganes Fier i kishte lene Shoqerise me ane te Njoftimit te Raport Kontrollit, po ne daten 26.09.2014, Dega e Doganes Fier me ane te njoftimit Nr. 2303/3, date 26.09.2014 i percjell Shoqerise Vendimin Nr. 133, date 26.09.2014 *"per shpalljen debitore te Shoqerise per shumen 589,786,660 leke ne forme detyrimi te akcizes dhe shumen 1,000,000 leke ne forme sanksionesh, ne favor te Administrates Doganore"* .

Ne datat 10 dhe 13 tetor 2014, BPAL ka marre respektivisht dy shkresa nga Dega e Doganes Fier me Nr. 2424 Prot., date 08.10.2014 dhe Nr. 2424/1 Prot., date 09.10.2014, ku i kerkohet BPAL-it qe ne baze te Ligjit per Akcizat dhe Aktit Administrativ 20805 (cituar nga Dega e Doganes Fier si shkresa Nr. 20805 Prot., date 05.09.2014), te paguaje detyrimin e akcizes, perndryshe, bazuar ne Nenin 20, pika 6, germa "e", do t'i revokohet Autorizimi i Magazines Fiskale (referuar ne vijim dy shkresat-akte administrative si **"Paralajmerimi per Revokim te Autorizimit te Magazines Fiskale"**).

Po ne daten 13 tetor 2014, BPAL njoftohet me ane te shkreses Nr. 23754/2 Prot., te DPD-se se i ndryshohet Autorizimi i Magazines Fiskale nga Magazine Fiskale ne Prodhim, ne Magazine Fiskale Stokimi (**"Akti Administrativ i Revokimit te Autorizimit te Magazines Fiskale"** ose **"Akti Administrativ 23754"**).

Ne daten 13 tetor 2014, DDF i dergon Paditesit shkresen Nr. 2446/3 Prot. Date 11.10.2014 per nje kontroll ne lidhje me respektimin nga BPAL te kushteve te Magazines se saj Fiskale, nga datat 11 deri 14 tetor 2014. Ky kontroll sic shprehet DDF-ja ne shkresen e saj, ushtrohet ne baze te Aktit Administrativ 23754 te DPD-se.

Për sa më sipër paditësi i është drejtuar Gjykatës me padinë objketi i të cilës është cituar më lart,

Pala paditëse në parashtrësit e saj pretendoi:

- Të shfuqizohen aktet administrative te Drejtorise se Pergjithshme te Doganave (i) Nr. 14151 Prot., date 11.06.2014; dhe (ii) Nr. 20805 Prot., date 05.09.2014 ne zbatim te Ligjit Nr. 61/2013 "Per akcizat ne Republiken e Shqiperise", i ndryshuar; aktit administrativ te Drejtorise se Pergjithshme te Doganave Nr. 23754/2 Prot., date 13.10.2014 (Revokimi i Autorizimit te Magazines Fiskale ne Prodhim) pasi ato janë akte që janë nxjerrë jo ne zbatim te Ligjit Nr. 61/2013 "Per akcizat ne Republiken e Shqiperise", i ndryshuar dhe të rregullohen pasojat juridike qe vijne nga ky shfuqizim duke rikthyer palet ne situaten e meparshme, duke i rikthyer/leshuar Paditesit Autorizimin e Magazines Fiskale ne Prodhim;
- Pra, nese nje produkt energjetik, sic eshte holluesi me kod E450 (solar) ose me kod E440 (Gazoil 0.1), duhet te paguaje akcize ose jo, ky percaktim nuk behet ne baze te origjines se nga vjen produkti, por behet

mbi bazen e menyres se perdorimit, pra nese sherben si lende djegese ose karburant per motoret, duke u hedhur per konsum.

- Ne ndryshim nga sa pretendon DPD-ja ne aktet administrative objekt kundershimi ne kete Padi, as germa "dh" e paragrafit 3 te Nenit 10 te Ligjit per Akcizat dhe as Neni 96/1 i VKM-se 612, ndryshuar me VKM-ne 501, nuk gjejne zbatim ne rastin e holluesit te perdorur nga Paditesi.
- Nga kuptimi i paragrafeve 2 dhe 3 si edhe Neni 51, paragrafi 1 i Ligjit per Akcizat, rezulton se nje produkt energjistik behet objekt akcize ne rastin kur ai perdoret per djegje ose si karburant per motore, qofte duke u hedhur ne treg per konsum, qofte kur perdoret per konsum vetjak. Per ta ilustruar kete llogjike, e cila eshte kristal e paster, ne paragrafin 3 te Nenit 4 te Ligjit per Akcizat, parashikohet si moment i hedhjes per konsum edhe "...c) momenti i konsumimit te produkteve te akcizes per qellime vetjake brenda ambienteve te magazines fiskale;".
- Per keto arsye, cdo pretendim i DPD-se se detyrimi per pagimin e akcizes per produkte energjetike te perdorura si hollues per t'u trupezuar me tej ne naften bruto prodhuar nga Paditesi, eshte i lidhur me ndryshimet si pasoje e Ligjit 180/2013 eshte absurd per shkak se jo vetem qe dispozita e shfuqizuar (perjashtimi i akcizes per nenproduktet e naftes se importuar) ka tjetër fushe zbatimi, pra nuk rregullon rastin e perdorimit te holluesit nga BPAL, por mbi te gjitha perderisa nuk e ka rregulluar me pare kete marredhenie, nuk mund ta cenoje tani pas shfuqizimit, perderisa nuk behet fjale per produkt importi, por i siguruar ne vend.
- Akti Administrativ i Revokimit te Autorizimit te Magazines Fiskale buron nga qendrimi dhe interpretimi i gabuar i Ligjit per Akcizat nga DPD-ja. Kjo eshte pranuar shprehimisht nga DFF-ja ne shkresen-akt administrativ per Paralajmerimin per Revokimin e Autorizimit te Magazines Fiskale, e cila thote se (citojme): "*Ne rast te mospagimit te detyrimeve te akcizes ... do te kerkojme revokimin e Autorizimit te Magazines Fiskale*".

Nisur nga sa me siper, pala paditese, i kerkoi Gjykates, pranimin e padise, sipas objektit te vendosur ne kerkese-padi.

Pala e paditur Drejtoria e Pergjithshme e Doganave dhe avokatura e Shtetit në prapësimet e veta parashtruan si më poshtë:

- Shkresa numer 20805 prot datë 05.09.2014 dhe shkresa nr.14151 prot t ëdatës 11.06.2014 nuk sjellin asnjë pasojë juridike të drejtpërdrejtë dhe nuk janë akt administrative sipas kuptimit ët K.PR.Administrative .
- Paditësi nuk legjitimohet në kundërshtimin e këtyre shkresave pasi ato nuk i drejtohen në mënyrë individuale paditësit.

- Ligji për akcizën në mënyrë tekstuale ka përjashtuar nga pagesa e akcizës nënproduktet e naftës vetëm në rastin e importimit cka nënkupton se sigurimi i këtij produkti nga tregu i brendshëm përderisa nuk është i cituar shprehimisht si rast përjashtimor nga ligji do të thotë se nuk përfiton përjashtim pra duhet të paguhet akcizë.
- Pas shfuqizimit të gërmës dh të pikës 3 të nenit 10 të ligjit për akcizat nënproduktet e naftës , solari në rastin konkret, nuk përjashtohet nga pagesa e akcizës kur importohet nga shoqëria hidrokarbure dhe të cilat i përdorin këto nënprodukte për nevojat e veta.
- Për solarin duhet të paguhet taksa e akcizës pa dallim sit ë rastin kur ky product importohet ashtu edhe në rastin kur shoqëritë e sigurojnë atë nga tregu i brendshëm.
- Është allogjike pretendimi i paditësit se nisur nga fakti se nuk e hedh solarin për konsum në territory nuk lind detyrim akcize për të paguar për këtë product.
- Hedhja e produktit të akcizës për konsum në territorin e vendit nuk përbën momentin e vetëm të lindjes se akcizës por gjithashtu hedhja për konsum do të presupozojë në kuptim të ligjit edhe një sër rastesh të tjera ndër të cilat përfshihet edhe rasti objekt gjykimi.
- Pretendimi i trupëzimit të solar me naftën bruto nuk është argument i cili shmang detyrimin e Bankersit për pagesën e akcizës për produktin solar.
- Në pikpamje të ligjit dy produktet janë qartësisht të diferencuara dhe mospagesa e akcizës për solarin nuk mundet të justifikohet me detajime teknike qoftë edhe ato të trupëzimit të këtij produkti me një product tjetër për të cilin nuk paguhet akcizë.
- Jemi para rastit t ëndryshimit të autoriizmit fillestar pasi Dogana ka konstatuar se autorizimi për magazinën fiskale prodhimi është dhënë në tejkalim të përcaktimit dh edetyrimeve ligjore .
- Është konstatuar se gjatë ushtrimit të aktivitetit të saj paditësi blen nga tregu i brendshëm apo importi produkte akcize për nevoja të konsumit të vet.Në këto kushte administrate doganore ka vlerësuar sit ë mbështetur ligjërisht mundësimin e dhënies së statutit të magazinës fiskale të stokimit lidhur me këto produkte element ky që padyshim krijon lehtësi në aktivitetin e shoqërisë Bankers Petroleum LTD.
- Ndryshimi i statusit ka ardhur si pasojë e verifikimit të gjithë veprimtarisë dhe nuk ka qënë e kushtëzuar aspak nga ndryshimi i ligjit të akcizës.Bankers nuk ka qënë prodhues apo përpunues edhe përpara ndryshimeve ligjore apo shkresore objekt gjykimi.

Nisur nga sa me sipër, perfaqesuesi i pales se paditur, i kerkoi gjykates, rrezimin e padise.

Ne perfundim te shqyrtimit gjyqesor Gjykata konkludon se kerkese padia duhet te pranohet per keto arsye:

Përsa i përket themelit të kësaj çështjeje, gjykata nga pikpamja procedurale zbaton dispozitat e mëposhtme:

Neni 3, pika 1 e ligjit Nr.49/2012, datë 03.05.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative“, parashikon : “Gjykata, në gjykimin administrativ, siguron nëpërmjet një procesi të rregullt gjyqësor dhe brënda afateve të shpejta e të arsyeshme, mbrojtjen juridike të të drejtave, lirive dhe interesave kushtetues dhe ligjorë të subjekteve, që mund të çënohen si pasojë e ushtrimit ose jo të funksioneve publike nga ana e organeve të administratës publike“

Neni 17, pika 2 e ligjit Nr.49/2012 përcakton se : “Gjykata zgjidh mosmarrëveshjet në përputhje me dispozitat ligjore dhe normat e tjera në fuqi, që janë të detyrueshme. Ajo bën një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen, pa u lidhur me përcaktimin që mund të propozojnë palët”.

Neni 34/ 1 i tij parashikon :“Seanca gjyqësore zhvillohet sipas neneve të Kodit të Procedurës Civile, për aq sa ato janë të pajtueshme me këtë ligj”.

Neni 37/1 përcakton : “Gjykata shqyrton ligjshmërinë e veprimit administrativ që kundërshtohet, në bazë të provave të paraqitura nga palët dhe të situatës ligjore dhe faktike që ekzistonte në kohën e kryerjes së veprimit konkret administrative”.

Gjykata konkludon se analiza juridike e pranimit të padisë do të bëhet referuar bazës ligjore si më poshtë:

- Ligjit Nr. 61/2012 “Per akcizat ne Republiken e Shqiperise”, i ndryshuar .

- Neni 115 i Kodit të Procedurave Administrative në të cilin parashikohet se:

“Pavlefshmeria e akteve administrative, ne kuptimin e ketij Kodi, paraqitet ne format e meposhtme:

a) akte administrative absolutisht te pavlefshme (akte te nxjerra ne kundershkrim flagrant me ligjin);

b) **akte administrative relativisht te pavlefshme (akte te nxjerra ne kundershkrim me ligjin)”.**

-Neni 118 i Kodit të Procedurave Administrative në të cilin parashikohet se: “ 1. Aktet administrative do te quhen relativisht te pavlefshme, ne kuptimin e ketij Kodi, kur ato jane nxjerre ne kundershkrim me ligjin, por meqjithate nuk jane absolutisht te pavlefshme.

2. Nje akt administrativ relativisht i pavlefshem eshte i ankueshem ne rruge administrative dhe gjyqesore perkatesisht mbi bazen e dispozitave te ketij Kodi dhe te Kodit te Procedures Civile”.

Gjykata referuar dispozitave ligjore përkatëse mori në analizë provat e administruara në këtë gjykim dhe konkludoi në zgjidhjen juridike të çështjes si më poshtë:

Së pari Proceduralisht paditësi ka legjitimitet aktiv në ngritjen e kësaj padie ,pasi ka interes të ligjshëm. Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, parashikon se: “Të drejtën e ngritjes së padisë e ka çdo subjekt, që pretendon se i është cenuar ***një e drejtë apo një interes i ligjshëm*** nga një veprim apo mosveprim i organit publik” (neni 15/a). Drejtoria e Pergiithshme e Doganave është organi me i larte, vendimet e te cilit jane te ankimueshme drejteperdrejte ne gjykatën kompetente. Aktet administrative te DPD-se, perfaqesuar nga Drejtori i Pergjithshem dalin ne zbatim dhe interpretim te legjislacionit doganor dhe konkretisht te Ligjit per Akcizat, ne rastin tone. Drejtoria e Pergiithshme e Doganave ka kompetenca ekzekutive dhe është një agjensi ligjzbatuese e pavaruar, vendimet e te ciles jane objekt shqyrtimi gjyqesor.

Së dyti Në lidhje me shterimin e ankimit administrative Gjykatat akonkludon se nuk jemi para rastit kur duhet te konsumohet rruga administrative paraprakisht.

Neni 16 i Ligjit Nr. 49/2012 “Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarreshjeve administrative”, i ndryshuar (“**Ligji 49/2012**”), parashikon se:

“1. Padia ndaj veprimit administrativ mund te ngrihet vetem pas shterimit te ankimit administrativ.

2. Perjashtohen nga ky rregull rastet kur:

a) ligji nuk parashikon organ me i larte per paraqitjen e ankimit administrativ, ose kur organi me i larte administrativ nuk është konstituuar;

b) ligji parashikon shprehimisht te drejten per t’u ankuar ndaj veprimit administrativ drejteperdrejt ne gjykatë;

c) organi me i larte ne shqyrtimin e nje ankimi administrativ ka cenuar, me vendimin e tij, te drejtat apo interesat personale te ligjshem te nje personi, i cili nuk ka qene pale ne procedimin administrativ.” [nenvizimi yne]

Jo vetem qe nuk ka asnje dispozite detyruese per te ndjekur rrugen e animimit administrativ ndaj vendimeve te Drejtorit te Pergjithshem te Doganave sipas ligjeve ne fuqi qe rregullojne aktivitetin e ketij institucioni (si psh Kodi Doganor, etj.), por del qartazi nga fryma e Nenit 104 e vijues i Ligjit per Akcizat, i interpretuar ne baze te neneve 7, 8 e vijues te Ligjit 49/2012, qe vendimet e Drejtorit te Pergjithshem te Doganave jane te ankimueshme drejteperdrejte ne Gjykatën Administrative.

Së treti: Bazuar ne **nenet 15,17,18 te ligjit 49/2012** , paditësi legjitimohet ne ngritjen e kesaj padie , brenda afatit ligjore 45 ditore i

është drejtuar gjykates , duke kerkuar **Shfuqezimi teresisht te akteve administrative të sipërcituara.**

Së katërti: : Përsa i përket themelit të kësaj çështjeje, gjykata konkludon se në nenin 16 të K Pr Civile është parashikuar se :”**Gjykata e zgjidh mosmarrveshjen ne perputhje me dispozitat ligjore dhe normat e tjera ne fuqi qe jane te detyrueshme te zbatohen prej saj**“,si dhe **Nenit 17, pika 2 e ligjit Nr.49/2012 përcakton se :** “Gjykata zgjidh mosmarrëveshjet në përputhje me dispozitat ligjore dhe normat e tjera në fuqi, që janë të detyrueshme. Ajo bën një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen, pa u lidhur me përcaktimin që mund të propozojnë palët”.

Së pesti:Gjykata cmon të theksoje në referim të zgjidhjes së drejtë të çështjes përmbajtjen e nenit 35 të Ligjit nr. 49 të vitit 2012 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrveshjeve Administrative”. Në këtë nen parashikohet shprehimisht se: “**Organi publik ka detyrimin të provojë ligjshmërinë e aktit administrativ**, kontratës administrative dhe të veprimit tjetër administrativ, të nxjerrë jo me kërkesë të paditësit, si dhe faktet që ai ka parashtruar dhe ka vënë në themel të veprimtarisë së kundërshtuar në gjykatë.Organi i administratës publike ka detyrimin të provojë ligjshmërinë e veprimeve në marrëdhënien e punës, nga e cila ka lindur mosmarrëveshja, objekt gjykimi.Në rastet e tjera, pala ka detyrimin të provojë faktet, në të cilat bazon pretendimin e saj. Por edhe në këto raste, gjykata, edhe kryesisht, me vendim të ndërmjetëm, mund të vendosë kalimin e barrës së provës tek organi publik, kur ka dyshime të arsyeshme, të bazuara në prova me shkresë, që vërtetojnë se organi publik fsheh apo nuk paraqet me dashje fakte dhe prova të rëndësishme për zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Ky vendim ankimohet së bashku me vendimin përfundimtar”. Ky është një moment i rëndësishëm për tu mbajtur parasysh në gjykimin e posacëm administrative pasi ligjshmëria e veprimtarisë administrative (në cdo formë qoftë ajo) është detyrim për tu provuar nga pala e paditur organ publik. Pra barra e provës për të provuar se aktet administrativ objekt atakimi në gjykatë janë të ligjshëm dhe për rrjedhojë nuk duhet të çenohet vlefshmëria e tyre i takon organit publik.

Së gjashti : Gjykata çmon se ngritja e padise ne kuptim te Nenit 16, 17 të ligjit nr.49/2012 , qe perfshihet ne bazen juridike te kerkespadise qe shqyrtojme, kerkon plotesimin njekohesisht te tre kushteve: (1) te kemi nje akt administrativ, (2) ky akt te jete i paligjshem dhe (3) nga kjo paligjshmeri paditesit t'i jene cenuar drejtperdrejt apo terthorazi, te drejtat subjektive apo interesat legjitime.

Rrjedhimisht, çështja e pare qe shtrohet per zgjidhje para kesaj gjykate ka te beje me faktin nese perfaqeson apo jo akt administrativ Shkresa Nr. 14151 Prot., date 11.06.2014; shkresa Nr. 20805 Prot., date 05.09.2014 dhe shkresa Nr. 23754/2 Prot., date 13.10.2014 të DPD

Neni 2 K.Pr.Administrative, i perfshire ne bazen juridike te kerkespadise, parashikon se:

“1.Veprimtaria e organeve administrative është tërësia e akteve dhe veprimeve nëpërmjet të cilave formohet dhe manifestohet vullneti i administratës publike, si dhe ekzekutimi i këtij vullneti.

2. Format e veprimtarisë administrative të rregulluara me këtë ligj janë:

- aktet administrative individuale dhe kolektive...”

Me tej, Neni 105 K.Pr.Administrative, gjithashtu i përfshirë në bazën juridike të kërkespadiçës, parashikon se: *“...“...do të konsiderohen akte administrative të gjitha vendimet e organeve të administratës publike të cilat krijojnë pasoja juridike për palët”*.

Neni 2 (Perkufizime) i Ligjit 49/2012, përmban ndër të tjera perkufizimet si vijon:

“1. “Akt administrativ” është çdo akt administrativ individual dhe çdo akt nenligjor normativ.

2. “Akt administrativ individual” është çdo vullnet i shprehur nga organi publik, në ushtrim të funksionit të tij publik, ndaj një ose disa subjekteve individualisht të përcaktuara të së drejtës, që krijojnë, ndryshojnë ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete.

(...)

6. “Organ publik” është çdo organ i pushtetit qendror, i cili kryen funksione administrative, çdo organ i enteteve publike, në masën që ato kryejnë funksione administrative; çdo organ i pushtetit vendor që kryen funksione administrative; çdo organ i Forcave të Armatosura, çdo strukturë tjetër, punonjësit e së cilës gëzojnë statusin e ushtarakut, për aq kohë sa këto kryejnë funksione administrative, si dhe çdo person fizik ose juridik, të cilit i është dhënë me ligj, akt nenligjor ose çdo lloj forme tjetër, të parashikuar nga legjislati në fuqi, e drejta e ushtrimit të funksioneve publike.

7. “Veprim administrativ” është akti administrativ, kontrata administrative dhe veprimi tjetër administrativ.

8. “Veprim tjetër administrativ” është çdo formë e njëanshme e veprimtarisë së organit publik, në kryerjen e funksionit publik dhe që nuk plotëson kushtet për të qenë akt administrativ apo kontratë dhe që krijojnë pasoja juridike mbi të drejtat subjektive apo interesat e ligjshme.”

Duke interpretuar Nenin 15, germa “a” me perkufizimet e pikave 1, 2, 6, 7 dhe/ose 8 të Nenit 2 të Ligjit 49/2012, është e qartë se kushti i parë që një akt administrativ të jetë i ankimueshëm në gjykatën administrative, ka të bëjë me krijimin e pasojave juridike, lindje detyrimesh ose të drejtash, si pasoje e ushtrimit të një funksioni, kompetence, ose tagri dhënë nga ligji, me anë të të cilit, organi administrativ shpreh vullnetin dhe pushtetin e tij diskrecionar.

Kushti i dytë ka të bëjë me cenimin e të drejtave dhe interesave të ligjshme të çdo subjekti për shkak të veprimit ose aktit administrativ të organit publik përkatës.

Ne rastin e kesaj Padie, te dy keto kushte jane plotesuar rregullisht, per shkak se:

- DPD-ja me ane te Aktit Administrativ 14151 dhe Aktit Administrativ 20805, shfuqizimi i te cileve kerkohet me ane te kesaj padie, ka percaktuar ne menyre te paligjshme detyrimin per akcize ndaj Paditesit ne lidhje me holluesin sipas fakteve relatuar me siper, pra ka ndryshuar nje marredhenie juridike, duke percaktuar detyrimin e pagimit te akcizes, ne ndryshim nga me pare, kur ky detyrim nuk ekzistonte.

- Vendimi 133 i Deges se Doganes Fier eshte pasoje e drejtperdrejte e Aktit Administrativ 14151 dhe Aktit Administrativ 20805, me ane te cilave, DPD-ja ka bere nje interpretim dhe zbatim te gabuar te ligjit te posacem dhe akteve nenligjore te dala ne zbatim te tij. Pra, DPD-ja ka ushtruar kompetencat e saj, duke shprehur vullnetin dhe autoritetin e saj ne interpretimin dhe zbatimin e dispozitave ligjore (ligj dhe aktet nenligjore).

Me ane te Aktit Administrativ 14151 fillimisht dhe me vone me ane te Aktit Administrativ 20805, DPD-ja ka urdheruar Degen e Doganes Fier qe te percaktoje detyrimin konkret te akcizes mbi produktin solar (gjysme produkt hollues), dhe kjo e fundit ka vepruar pikerisht sipas urdherimit te organit te saj epror.

Akti Administrativ 20805 i eshte komunikuar edhe Paditesit nga DPD-ja, gje e cila verteton edhe nje here interesin legjitim te Paditesit ne kundershkrimin e aktit ne fjale, ne kuptim te Nenit 17, paragrafi 1, germa "a" te Ligjit 49/2012.

Gjithashtu, Paditesi ka nje interes legjitim ne saktesimin e te drejtave dhe detyrimeve te gernes "dh" te se njejtës dispozite, perderisa nga ky saktesim do te varen ne te ardhmen veprimet administrative ose vendimmarrja e DPD-se dhe organeve te saj te vartesisë.

Së Shtati: Pala paditëse parashtron pretendime që lidhen me një ***pavlefshmëri relative*** të aktit administrativ Si rrjedhojë e kësaj pavlefshmërie pala paditëse kërkon shfuqizimin e aktit administrative me arsyetimin se ky akt është marrë nga ana e pala e paditur në kundërshtim me ligjin .

Nga analiza e dispozitës së sipërcituar rezulton se :

Pavlefshmëria relative rregullohet në nenin **118** të K.Pr.Administrative, i cili parashikon se:

“ 1. Aktet administrative do te quhen relativisht te pavlefshme, ne kuptimin e ketij Kodi, kur ato jane nxjerre ne kundershkrim me ligjin, por megjithate nuk jane absolutisht te pavlefshme.

2. Nje akt administrativ relativisht i pavlefshem eshte i ankueshem ne rruge administrative dhe gjyqesore perkatesisht mbi bazen e dispozitave te ketij Kodi dhe te Kodit te Procedures Civile”.

Si rrjedhojë gjykata analizon shkeljet ligjore që i referohen anulimit të aktit që kundërshtohet nga pala paditëse brenda kufijve të pavlefshmërisë relative.

Për të analizuar nëse aktet administrative kanë dalë në zbatim të ligjit Gjykata merr në analizë dispozitat ligjore sipas Ligjit per Akcizat dhe akteve nenligjore

Neni 2 (Perkufizime te pergjithshme) i Ligjit per Akcizat, permban keto perkufizime:

“2. “Akcize” eshte nje takse qe zbatohet mbi produktet e akcizes, te prodhuara dhe te importuara, qe hidhen per konsum ne territorin e Republikes se Shqiperise.

6. “Regjim i pezullimit te detyrimeve” eshte nje regjim qe zbatohet ne prodhimin, perpunimin, mbajtjen ose levizjen e mallrave te akcizes te pambuluara nga nje procedure doganore pezulluese ose regjim doganor pezullues, i cili ka pezulluar pagesen e akcizes.

10. “Magazine fiskale” eshte nje ambient, qartesisht i ndare nga ambientet e tjera, ku produktet e akcizes prodhohen, perpunohen, mbahen, priten ose dergohen nen nje regjim pezullues te detyrimeve nga nje depozitues i miratuar ne ushtrimin e aktivitetit te tij, sipas kushteve te percaktuara nga autoritetet doganore.”.

Neni 4 (Lindja e detyrimit te akcizes), i cili ndodhet ne Kreun II, Seksioni 1 (Momenti dhe vendi i lindjes se detyrimeve te akcizes, deklarimi, pagesa) te Ligjit per Akcizat, parashikon se:

“1. Per mallrat e akcizes detyrimi i akcizes lind ne momentin e hedhjes se mallit per konsum ne territor.

2. Per qellime te ketij ligji, konsiderohen hedhje per konsum ne territor:

a) dalja, perfshire edhe daljen e parregullt, e produkteve te akcizes nga nje regjim i pezullimit te detyrimeve;

b) mbajtja e produkteve te akcizes jashte nje regjimi pezullues te detyrimeve, ku akciza nuk eshte vjele sipas ketij legjislacioni;

c) prodhimi, perfshire edhe prodhimin e parregullt, i produkteve te akcizes, jashte nje regjimi te pezullimit te detyrimeve;

ç) importi, perfshire edhe importin e parregullt, i produkteve te akcizes, me perjashtim te rastit kur produktet, menjehere pas importit, jane futur nen nje regjim te pezullimit te detyrimeve.

3. Momenti i hedhjes per konsum eshte gjithashtu:

a) momenti i dergimit te produkteve te akcizes nga nje depozitues i miratuar drejt nje personi juridik ose fizik, qe nuk eshte i autorizuar te prese mallra akcize nen regjimin e pezullimit te detyrimeve;

b) momenti i prodhimit te produkteve te akcizes pertej sasive te parashikuara ne nenet 66 e 73 te ketij ligji;

c) momenti i konsumimit te produkteve te akcizes per qellime vetjake brenda ambienteve te magazines fiskale;

ç) momenti i krijimit te humbjeve apo firove te produkteve te akcizes, me perjashtim te humbjeve dhe firove te shfaqura gjate periudhes se pezullimit te detyrimeve, nese depozituesi i miratuar mund te provoje qe keto humbje apo firo kane ardhur si rezultat i nje ngjarjeje te paparashikuar ose force

madhore, ose qe keto humbje a firo te lidhura ne menyre te pandashme me karakteristikat e produktit jane shfaqur gjate prodhimit, magazinimit dhe transportit te produkteve te akcizes;

d) dita kur autorizimi i depozituesit te miratuar ose autorizimi i perjashtimit nga detyrimi i akcizes pushojne se qeni te vlefshem, sipas dispozitave te ketij ligji;

dh) momenti kur pritesi i regjistruar merr mallra akcize nen regjimin e pezullimit te detyrimeve, sipas nenit 30 te ketij ligji.” [theksimi yne]

Titulli II (Dispozita Specifike per Produktet e Akcizes), parashikon ne Kreun VII (Produktet Energjetike), rastet kur nje produkt energjetik paguan akcize. Pra, ne vazhdim te perkufizimit qe jep Neni 4 ne lidhje me castin e lindjes se detyrimit te akcizes ne pergjithesi, ne kete pjese te Ligjit per Akcizat, behet perkufizimi edhe me i qarte dhe specifik i rastit te akcize per produktet energjetike, sic eshte nafta bruto, nenproduktet e saj dhe holluesi objekt konflikti.

Neni 50 (Perkufizime) i Ligjit per Akcizat, parashikon si vijon:

“1. Ne kuptim te ketij ligji, konsiderohen produkte energjetike produktet e meposhtme:

(...)

b) qe klasifikohen ne kodet NK 27 01, 27 02 dhe 27 04 deri 27 15;

(...)

2. Produkte energjetike konsiderohen gjithashtu:

a) produkte te tjera me qellim konsumi, te vena ne shitje me pakice ose te perdorura si lende djegese per motore;

b) shtues ose mbushes te lendes djegese te motoreve, nese deklarohen si te tilla;

c) hidrokarbure te tjera te vendosura ne shitje me pakice ose te perdorura per ngrohje, me perjashtim te torfes ose biomases. Biomasa perfshin nje fraksion te nje produkti, i cili mund te biodegradohet, mbetje nga bujqesia, duke perfshire substanca me origjine nga bimet ose kafshet, nga pylltaria dhe industrite e lidhura me to, si dhe fraksionet biodegraduese te mbetjeve industriale dhe urbane.

3. Çdo produkt i percaktuar ne shkronjat “a”, “b” e “c” te pikes 2 te ketij neni dhe çdo produkt tjetër, qe perdoret si zevendesues, mbushesh ose shtues per lendet djegese ose karburantet, i nenshtrohet pageses se akcizes, sipas te njejtit nivel akcize dhe ne baze te te njejtave kushte, si per lendet djegese ose karburantin, te cilen ka zevendesuar, mbushur ose shtuar.” [nenvizimi yne]

Neni 51 (Produktet qe paguajne akcize), paragrafi 1 i Ligjit per Akcizat, percakton rastin se per cfare lloj produkti energjetik zbatohet detyrimi i akcizes, si vijon:

“Mallrat e akcizes te ketij seksioni perfshijne produktet energjetike te perdorura si karburante per motoret, lende djegese.”

Sipas Shtojces Nr. 1 te Ligjit per Akcizat, ku percaktohet kategoria dhe nomenklatura per nje produkt energjetik, vajrat e renda (Gazoil) me kod E440, si edhe vajra te rende si lende djegese (lende djegese, solar, mazut) me kod E450, klasifikohen ne kodet NK 27 01, 27 02 dhe 27 04 deri 27 15, sipas gernes "b" te paragrafit 1 te Nenit 50 te Ligjit per Akcizat, referuar me siper. Nga analiza e perkufizimit te Nenit 2, pika 2, Nenit 4, paragrafi 1 dhe Nenit 51, paragrafi 1 te Ligjit per Akcizat, rezulton se duhet te permbushen dy kushte qe akciza te zbatohet mbi nje produkt energjetik:

- 1- produkti energjetik te jete i destinuar si "*karburant per motoret [ose] lende djegese*";
- 2- 2-) "*te hidhet per konsum ne territor*".

Pra, nese nje produkt energjetik, sic eshte holluesi me kod E450 (solar) ose me kod E440 (Gazoil 0.1), duhet te paguaje akcize ose jo, ky percaktim nuk behet ne baze te origjines se nga vjen produkti, por behet mbi bazen e menyres se perdorimit, pra nese sherben si lende djegese ose karburant per motoret, duke u hedhur per konsum.

Ne ndryshim nga sa pretendon DPD-ja ne aktet administrative objekt kundershimi ne kete Padi, as germa "dh" e paragrafit 3 te Nenit 10 te Ligjit per Akcizat dhe as Neni 96/1 i VKM-se 612, ndryshuar me VKM-ne 501, nuk gjejne zbatim ne rastin e holluesit te perdorur nga Paditesi.

Nga kuptimi i paragrafeve 2 dhe 3 si edhe Neni 51, paragrafi 1 i Ligjit per Akcizat, rezulton se nje produkt energjetik behet objekt akcize ne rastin kur ai perdoret per djegje ose si karburant per motore, qofte duke u hedhur ne treg per konsum, qofte kur perdoret per konsum vetjak. Per ta ilustruar kete llogjike, e cila eshte kristal e paster, ne paragrafin 3 te Nenit 4 te Ligjit per Akcizat, parashikohet si moment i hedhjes per konsum edhe "*...c) momenti i konsumimit te produkteve te akcizes per qellime vetjake brenda ambienteve te magazines fiskale*".

Per keto arsye, pretendim i DPD-se se detyrimi per pagimin e akcizes per produkte energjetike te perdorura si hollues per t'u trupezuar me tej ne naften bruto prodhuar nga Paditesi, eshte i lidhur me ndryshimet si pasoje e Ligjit 180/2013 eshte i pabazuar per shkak se jo vetem qe dispozita e shfuqizuar (perjashtimi i akcizes per nenproduktet e naftes se importuar) ka tjeter fushe zbatimi, pra nuk rregullon rastin e perdorimit te holluesit nga BPAL, por mbi te gjitha perderisa nuk e ka rregulluar me pare kete marredhenie, nuk mund ta cenoje tani pas shfuqizimit, perderisa nuk behet fjale per produkt importi, por i siguruar ne vend.

Dispozita e shfuqizuar, parashikonte se: "*importimi i nenprodukteve te naftes, per nevojat e veta, nga subjektet e kerkimit te naftes dhe te venies ne shfrytezim te zonave naftembajtese, ne rast te plotesimit te kushteve specifike, sipas legjislacionit dhe marreveshjeve per kete qellim...*".

Situata e referuar me lart gjen nje rregullim ligjor edhe nga VKM 612 dhe VKM 501 te dy keto akte nenligjore jane nxjerre dhe kane hyre ne fuqi, perpara miratimit dhe hyrjes ne fuqi te Ligjit 180/2013. Aktet nenligjore jane nxjerre respektivisht ne 2012 dhe maj 2013 nderkohe qe Ligji 180/2013 eshte

miratuar ne dhjetor 2013. Shfuqizimi i germes "dh" te paragrafit 3 te Nenit 10 te Ligjit per Akcizat ka hyre ne fuqi ne 1 prill 2014.

Neni 96/1 i VKM-se 612, ndryshuar me VKM-ne 501, parashikon se:

- “1. Produktet energjetike sipas aneksit 24 qe i bashkelidhet ketij vendimi, te cilat importohen (hidhen per qarkullim te lire) ose blihen prane magazinave fiskale te prodhimit brenda vendit dhe qe kane destinacion mbajtjen (magazinimin) e tyre me qellim levizjen e mevonshme drejt pikave te shitjes me pakice, detyrimisht futen ne nje magazine fiskale stokimi me detyrim akcize te pezulluar.*
- 2. Per qellime te ketij vendimi, do te konsiderohen pika shitjeje me pakice edhe depozitat e kompanive qe i perdorin keto produkte energjetike per nevoja te furnizimit te automjeteve te tyre apo ushtrimit te aktivitetit.”*

Rezultoi se jo vetëm Gazoili 0.1, me kod E440, por edhe solari me kod E450, te perfshira ne Aneksin 24, bashkelidhur VKM-se 501, nuk jane perdorur nga Paditesi per qellimin e pershkruar ne paragrafet 1 dhe 2 te dispozites te sapo cituar.

Pra, ky shfuqizim dhe parashikimet e dy akteve nenligjore ne fjale nuk jane te lidhura me njera-tjetren. Gjykata konkludon se argumentimi i DPD-se ne Aktin Administrativ 20805 nuk qendron, pasi nuk ka asnje ndryshim ne regjimin juridik te trajtimit te produkteve si solari, etj. qe i perkasin kategorise E450 te nomenklatures se produkteve energjetike prej dates 1 prill 2014 sic pretendon DPD-ja.

Së tetti: Sic rezulton e provuar nga shkresat mes paleve ne gjykim, cituar me siper dhe depozituar ne cilesine e proves holluesi i eshte nenshtruar regjimit te pezullimit, ne magazinën fiskale te prodhimit te BPAL. Sipas perkufizimi ne pikat 5 dhe 10 te Nenit 2 te Ligjit per Akcizat (cituar me lart), nje nga qellimet e regjimit te pezullimit eshte percaktimi i detyrimit per akcize ne raport me perdorimin faktik te produktit energjetik konkret. Pra, ne castin qe holluesi eshte trupezuar me naften bruto, ky eshte nje produkt i vetem dhe holluesi nuk eshte konsumuar, ndaj nuk ka se cfare akcize te zbatohet ndaj tij.

Ne te kundert, DPD-ja, ose Dega Doganore Fier, ose dege te tjera doganore apo agjensi te tjera ligjzbatuese nuk kane konstatuar asnjehere qe Paditesi ose persona te tjere te lidhur me te, e perdore solarin ose hollues te tjere jo per qellimin e deklaruar nga dhe as rivleresimi qe ka bere Dega Doganore Fier ne Procesverbalin e Konstatimit eshte bazuar ne deklarimet e Paditesit dhe ne asnje kontroll fizik apo faktik te aktivitetit te tij.

Së nënti: Nga Gjykimi rezultoi se Holluesi objekt konflikti nuk eshte produkt i konsumi. Sic e kemi permendur me siper, ne baze te Raport Analize te IQT gjysme produkti qe perdoret si hollues nga Paditesi (furnizuar nga te trete – shih Raport Analizen e IQT-se), nuk eshte produkt konsumi. Kjo do te thote qe nuk eshte i destinuar per t'u hedhur ne treg per konsum, ose qofte per konsum vetjak dhe per kete arsye nuk bie ne fushen e zbatimit te Neni 96/1 i VKM-se 612, ndryshuar me VKM-ne 501.

Ne kete menyre ky hollues i ploteson plotesisht kriteret e percaktuara nga Neni 51, paragrafi 1 i Ligjit per Akcizat dhe referimi i DPD-se ne Neni 96/1 i VKM-se 612, ndryshuar me VKM-ne 501 dhe dispoziten e Ligjit per Akcizat shfuqizuar nga Ligji 180/2013 eshte totalisht i gabuar pasi ky produkt energjistik nuk ka destinacion perdorimi dhe as nuk eshte perdorur ne fakt dhe as nuk eshte konstatuar nje perdorim i tille nga asnje kontroll.

Së dhjeti: Nuk mund te paguhet akciza dy here per nje produkt (nuk ka taksim te dyfishte).Ashtu si u shpjegua më lart , holluesi trupezohet ne naften bruto e cila i shitet rafinerise per trajtim te metejshem. Pas daljes nga rafineria i nen-produkteve qe jane subjekt akcize dhe shiten ne treg, akciza behet e pagueshme. Nga ana tjetere referuar interpretimit te DPD-se, nese Paditesi paguan akcize per holluesin, i cili trupezohet ne naften bruto si lende e pare e destinuar per rafinim dhe ne fund edhe per nenproduktet qe perftohen nga rafinimi, do te rezultonte qe akciza do paguhej dy here, nje here per lenden e pare (pra per holluesin) dhe ne fund per nenproduktin e perftuar qe hidhet ne treg per konsum (pra produktin final ne kuptim te zbatimit te akcizes). Kjo situatë paligjshmerie juridike ku per produktin eneregjistik do paguhej dy here e njejta takse (ne kete rast akciza), vjen si pasoje e interpretimit dhe zbatimit te gabuar te te Paditurit.

Së njëmbëdhjeti : Gjykata mori në analizë referua zgjidhjes ne themel të çështjes edhe ndryshimin e Marreveshjes Hidrokarbure, realizuar kjo me ane te Vendimit Nr. 726, date 02.11.2014 te Keshillit te Ministrave me miratimin e Marreveshjes se Dyte Ndryshuese e Marreveshjes Hidrokarbure, lidhur mes Albpetrol Sh.a. dhe Paditesit, me date 19.06.2014.

VKM 726 ka hyre ne fuqi pas botimit ne Fletoren Zyrtare Nr. 174, date 14.11.2014.

Ne hyrjen e Marreveshjes se Dyte Ndryshuese te Marreveshjes Hidrokarbure, percaktohet arsyeja pse palet kanë rënë dakord per ndryshimin e Marreveshjes Hidrokarbure, që kane te bejne me disa ndryshime fiskale, nder te tjera me ndryshimet e Ligjit per Akcizat, si pasoje e hyrjes ne fuqi te Ligjit 180/2013.

Ndryshimi kryesor qe Ligji 180/2013 ka sjelle ne Ligjin per Akcizat ka te beje me abrogimin e germes “dh”, te paragrafit 3 te Nenit 10 (Rastet e perjashtimeve) te Ligjit per Akcizat.

1. Neni 10 (Rastet e perjashtimeve), paragrafi 3 i Ligjit per Akcizat perpara shfuqizimit te germes “dh”, parashikonte si vijon:

“3. Perfitojne perjashtim nga pagesa e akcizes edhe:

a) produktet e akcizes qe eksportohen;

b) mallrat e akcizes qe jane vendosur nen regjimin e pezullimit doganor;

c) produktet energjetike me perdorim te dyfishte. Nje produkt eshte me perdorim te dyfishte kur eshte i destinuar njekohesisht si lende djegese dhe per perdorim te ndryshem nga ai i karburanteve ose i lendeve djegese. Perdorimi i produkteve energjetike per reduktimin kimik dhe elektrolizen, si dhe procese metalurgjike konsiderohen si nje perdorim i dyfishte;

ç) produktet energjetike te perdorura ne proceset mineralogjike;

- d) karburanti per anijet e peshkimit ne sasite, kushtet dhe kriteret e percaktuara me vendim te Keshillit te Ministrave;
- dh) importimi i nenprodukteve te naftes, per nevojat e veta, nga subjektet e kerkimit te naftes dhe te venies ne shfrytezim te zonave naftembajtese, ne rast te plotesimit te kushteve specifike, sipas legjislacionit dhe marreveshjeve per kete qellim. Procedurat per modalitet e perjashtimit dhe te zbatimit percaktohen ne aktet ligjore dhe nenligjore ne fuqi.
- e) karburanti qe perdoret nga avionet e linjave nderkombetare per tregti/transport nderkombetar, me perjashtim te atyre qe perdoren per perdorim privat apo nacional.” [nenvizimi yne]

Si pasoje e ketij abrogimi, shfuqizohet perjashtimi i parashikuar ne kete germe dhe importimi i nenprodukteve te naftes, i nenshtrohet regjimit te pagimit te akices. Pra, zbatohet i njejti regjim si per produktet e tjera te akcizes, sipas Ligjit per Akcizat.

Per kete arsye, sic edhe palet kane rene dakord ne hyrjen e Marreveshjes Ndryshuese, prej ndryshimeve fiskale ne fjale kerkohej ndryshimi i Marreveshjes Hidrokarbure ne perputhje me nenin 18.3 te Marreveshjes Hidrokarbure, ne menyre qe te ruhen perfitimet ekonomike te BPAL nga Marreveshja Hidrokarbure, ne perputhje me paragrafin 3(d) te nenit 5 te ligjit per hidrokarburet nr. 7746, date 28.07.1993, i cili ligj ka qene ne fuqi ne kohet e lidhjes se saj.

Neni 4 i Marreveshjes Ndryshuese ndryshon Nenin 13 te Marreveshjes Hidrokarbure, duke shtuar nje nen te ri 13.5, me permbajtje si vijon:

“13.5 Rregullimet e Ndryshimeve Fiskale AKQ

Taksa e akcizes

a) Neni 10, paragrafi “3/dh” i ligjit per akcizat parashikonte perjashtime nga taksa e akcizes per importimin e nenprodukteve te naftes (per nevojat e veta, nga subjektet e kerkimit te naftes dhe te venies ne shfrytezim te zonave naftembajtese, ne rast te plotesimit te kushteve specifike, sipas legjislacionit dhe marreveshjeve per kete qellim), qe perdoren ne operacionet hidrokarbure.

Ndryshimet Fiskale AKQ e kane shfuqizuar kete perjashtim nga taksa e akcizes duke filluar nga 1 prill 2014. Si rezultat i ketij shfuqizimi:

- i) Kontraktori eshte i detyruar te paguaje taksen e akcizes sipas ligjit per akcizat ne para (cash) tek autoritetet doganore per importin e mallrave qe i nenshtrohen takses se akcizes, ne perputhje me ligjin shqiptar; dhe
- ii) nje shume te barabarte me vleren e takses se akcizes e paguar nga Kontraktori pas dates 1 prill 2014 sipas pikes (i) me lart per importimin e nenprodukteve te naftes te perdorura ne operacionet hidrokarbure: (A)do te alokohet tek Kontraktori nga nafta e disponueshme; dhe B) do te perfshihet si kosto hidrokarbure, si pjese perberese e Rregullimeve te Ndryshimeve Fiskale AKQ.”

Kjo tregon se ndryshimi ne fjale, ndryshe nga sa pretendon i Padituri, eshte bere ne rradhe te pare per pasoje te ndryshimeve ligjore, pra heqjes se perjashtimit te akcizes ndaj nenprodukteve te naftes te importuara ne Shqiperi

dhe per te ruajtur perfitimet e Paditesit (Kontraktori sipas perkufizimit te Marreveshjes Hidrokarbure).

Konkretisht, ne Hyrjen e Marreveshjes Ndryshuese (faqja e pare, Rubrika "Meqenese"), shprehimisht eshte pranuar nga palet se :

"Meqenese Kontraktori ka te drejten ekskluzive te kryeje operacione hidrokarbure dhe te prodhoje hidrokarbure ne zonen e projektit te percaktuar ne Marreveshjen Hidrokarbure dhe Licence- Marreveshje;

Meqenese Palet njohin se zbatimi i ndryshimeve fiskale AKQ kerkon ndryshimin e Marreveshjes Hidrokarbure ne perputhje me nenin 18.3 te Marreveshjes Hidrokarbure, ne menyre qe te ruhen perfitimet ekonomike te Kontraktorit nga Marreveshja Hidrokarbure, ne perputhje me paragrafin 3(d) te nenit 5 te ligjit per hidrokarburet nr. 7746, date 28.07.1993".

Pra paragrafi i ri 13.5 i futur ne Marreveshjen Hidrokarbure, vetem sa merr parasysh kete ndryshim ligjor. Pra, kjo nuk tregon se Paditesi ka ndryshuar qendrim ndaj faktit se kur duhet paguar ose jo akciza, ne ndryshim nga sa pretendohet nga i Padituri. Perkundrazi, arsyeja se pse Paditesi ka pranuar te nenshkruaje Marreveshjen Ndryshuese, lidhet me faktin qe Paditesi do te perfitoje nga skema e mitigimit, pra nga skema e parashikuar ne piken i) dhe ii) te paragrafit te ri 13.5 cituar me siper. Sipas kesaj skeme, Paditesi mbron interesat e tij ekonomiko-financiar ne perputhje me te drejttat dhe garancite e dhena nga Marreveshja Hidrokarbure, duke u siguruar qe abrogimi i regjimit te akcize ndaj nenprodukteve te naftes te importuara te mos kene impakt ne interesat e tij te ligjshme.

Sic sanksionohet edhe ne paragrafin e ri 13.6 te Marreveshjes Hidrokarbure (Neni 4 i Marreveshjes Ndryshuese), ose si rrjedhoje e ndryshimeve te percaktuara ne Nenin 6.2 te Marreveshjes Hidrokarbure, etj., me ane te Marreveshjes Ndryshuese, eliminohen efektet ekonomike negative te ardhura si pasoje e ndryshimeve ne legjislacion, pra Ndryshimet Fiskale AKQ (sipas perkufizimit te Marreveshjes Ndryshuese).

Ndryshimi i Ligjit per Akcizat si pasoje e abrogimit te germes "dh" te paragrafit 3 te Nenit 10 te tij, kane te bejne vetem me importet, pra regjimin e akcizes mbi nenproduktet e naftes te importuara ne Shqiperi, ndryshim i cili nuk ka te beje me objektin e kesaj padie.

Gjithashtu, perderisa per shkak te ketij ndryshimi BPAL ka perfituar garanci shtese ose perfitime fiskale si ato te parashikuara nga Marreveshja Ndryshuese, ky i fundit nuk kishte asnje arsye qe te mos perfitonte nga ky trajtim. Pretendimi i DPD-se se duke pranuar nenshkrimin e Marreveshjes Ndryshuese, BPAL ka pranuar se holluesi i nenshtrohet akcizes, është i pambeshtetur ligjërisht pasi rastet se kur i nenshtrohet nje nenprodukt i naftes pagimit te akcize percaktohen nga Neni 50, 51 (te interpretuara ne harmoni me perkufizimet e Nenit 2, 4, etj.).

Ligjin per Akcizat nuk e interpreton BPAL dhe veprimet e tij nuk ndryshojne interpretimin ose zbatimin e tij dhe Marreveshja Ndryshuese lidhet ne menyre

strikte me perjashtimin e akcizes ndaj importeve dhe vjen nder te tjera si pasoje e abrogimit te ketij perjashtimi.

BPAL ne baze te parimit te lirise kontraktore dhe lirise se siper marrjes, parime kushtetuese te sanksionuara ne ligje specifike, ka lidhur Marreveshjen Ndryshuese per te mbrojtur interesat e tij te ligjshme, sic BPAL e ka çmuar te arsyeshme, ne lidhje me nje sere ndryshimesh fiskale, nder te tjera edhe per shkak te ndryshimeve te Ligjit 180/2013 ndaj Ligjit per Akcizat.

Kjo eshte arsyeja se pse BPAL ka hyre ne kete Marreveshje duke perfutuar nga qartesimi edhe me i tejshem i skemes se rimbursimit (mitigimit), pasi behet fjale per te drejta te sanksionuara ne Marreveshjen Hidrokarbure, si psh. perfshirja ne koston hidrokarbure, por qe per shkak te një kuptimi më të qartë palet e Marreveshjes i adresojne ne menyre te shprehur si pasoje e ndryshimeve fiskale.

Abrogimi i perjashtimit te importeve nga pagimi i akcize, ka nje impakt fiskal te caktuar per shkak te raportit te holluesit qe Paditesi siguron ose mund te siguroje ne tregun vendas, ose nga importi. Pra, pikerisht, ne zbatim te interesit te ligjshem si operator privat, BPAL ka vleresuar se per shkak te ndryshimit fiskal ne fjale, pasojat mund te rregulloheshin me ane te Marreveshjes Ndryshuese. Ne te kundert, nese pranohet qendrimi i DPD-se ne aktet e saj administrative dhe specifikisht pergjate prapesimeve te tyre gjate gjykimit, do te cenoheshin te drejtat e BPAL qe burojne nga Marreveshja Hidrokarbure. Pra, DPD-ja ne menyre te njeanshme do te ndryshonte keto te drejta dhe do te shkelte nje Marreveshje qe eshte ratifikuar nga shteti shqiptar (me ane te Keshillit te Ministrave).

Në referencë të analizës së sipërcituar Marreveshja e Dyte Ndryshuese e Marreveshjes Hidrokarbure lidhet ne menyre te ngushte dhe ekskluzive me Ligjin 180/2013 dhe abrogimin e gërmes “dh” te paragrafit 3 te Nenit 10 te Ligjit per Akcizat, i cili ka nje fushe zbatimi te mirepercaktuar (pra lidhet me importet) dhe nuk ka te beje me objektin e kesaj Padie dhe te drejtat dhe kerkimet e Paditesit.

Së fundmi: referuar Marreveshjes Ndryshuese, ne hyren e saj (faqja e pare), palet kane pranuar qartazi qe “... *Kontraktori ka te drejten ekskluzive te kryeje operacione hidrokarbure dhe te prodhoje hidrokarbure ne zonen e projektit te percaktuar ne Marreveshjen Hidrokarbure dhe Licence- Marreveshje*”.Pra, Pretendim i te Paditurit se revokimi eshte kryer ne perputhje me llojin e aktivitetit qe ushtron Paditesi, bie poshte nga vete teksti i Marreveshjes Ndryshuese, ku i Padituri pranon qe BPAL prodhon hidrokarbure! Per kete arsye, nuk ka asnje baze veprimi i te Paditurit dhe duhet rregulluar kjo pasoje, duke leshuar edhe nje here per Paditesin Autorizimin e Magazines Fiskale ne Prodhim.

Akti Administrativ i Revokimit te Autorizimit te Magazines Fiskale buron nga qendrimi dhe interpretimi i gabuar i Ligjit per Akcizat nga DPD-ja. Kjo eshte pranuar shprehimisht nga DFF-ja ne shkresen-akt administrativ per Paralajmerimin per Revokimin e Autorizimit te Magazines Fiskale, e cila thote se: “Ne rast te mospagimit te deturimeve te akcizes ... do te kerkojme revokimin e Autorizimit te Maqazines Fiskale”. Revokimi i Autorizimit te Magazines Fiskale

është pasoje juridike e interpretimit që i Padituri i ben detyrimeve te Paditesit ne lidhje me akcizen (pra keto veprime administrative bien ne fushen e kerkimit te Padise), shkresa-akt administrativ ne fjale e DPD-se perben prove per kete.

Në përfundim Gjykata referuar analizës së sipërcituar konkludon se padia është e bazuar në prova dhe në ligj dhe s'është e itillë duhet të pranohet.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata bazuar ne nenet nenet 7/a, 11/1, 15/a, 17/1/a, 18/1, 40,41,42 te Ligjit nr.49/2012 « Per organizimin dhe funksionimin e e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarreshjeve administrative , neni 118 e K.PR.Administrative

V E N D O S I

1. Pranimi e Padise se Paditesit Bankers Petroleum Albania LTD.
 2. Shfuqizimin teresisht te akteve administrative te Drejtorise se Pergjithshme te Doganave (i) Nr. 14151 Prot., date 11.06.2014; dhe (ii) Nr. 20805 Prot., date 05.09.2014 ne zbatim te Ligjit Nr. 61/2013 "Per akcizat ne Republiken e Shqiperise", i ndryshuar;
 3. Saktesimin e te drejtave dhe detyrimeve ndermjet paditesit Bankers Petroleum Albania LTD dhe te paditurit Drejtoria e Pergjithshme e Doganave ne lidhje me detyrimin e pretenduar nga i padituri per pagesen e akcizes sipas akteve administrative Nr. 14151 Prot., date 11.06.2014 dhe Nr. 20805 Prot., date 05.09.2014;
 4. Shfuqizimin teresisht te aktit administrativ te Drejtorise se Pergjithshme te Doganave Nr. 23754/2 Prot., date 13.10.2014 (Revokimi i Autorizimit te Magazines Fiskale ne Prodhim) ne zbatim te Ligjit Nr. 61/2013 "Per akcizat ne Republiken e Shqiperise", i ndryshuar dhe rregullimin e pasojave juridike qe vijne nga ky shfuqizim duke rikthyer palet ne situaten e meparshme, duke i rikthyer/leshuar Paditesit Autorizimin e Magazines Fiskale ne Prodhim;
- Ligjërimit e masës së sigurimit të marë në datën 15.10.2014 me anë të së cilës është vendosur Sigurimin e Padise duke pezulluar zbatimin e akteve administrative Nr. 14151 Prot., date 11.06.2014 dhe Nr. 20805 Prot., date 05.09.2014 te Drejtorise se Pergjithshme te Doganave, si edhe te pezullimit te detyrimit te akcizes deri ne saktesimin e te drejtave te Paditesit, si edhe te cdo akti administrativ nxjerre ne zbatim te ketyre dy akteve administrative nga vete i Padituri apo organet e vartesisë (si i tillë i pezulluar edhe **Akti Administrativ nr. 23754/2 i Revokimit te Autorizimit te Magazines Fiskale të datës 10 tetor 2014**) dhe mosmarrjen nga ana e te Paditurit te asnje veprimi, ose nxjerrje akti, urdhri apo vendimi per caktimin e detyrimeve ne lidhje me akcizen dhe

pezullimin e pasojave juridike qe burojne nga keto veprime administrative, deri ne perfundim te shqyrtimit te padise ne lidhje me saktesimin e te drejtave dhe detyrimeve mes paleve ne gjykim. deri ne perfundim te procesit gjyqësor .

- Shpenzimet gjyqsore në ngarkim të palës të paditur.
- Kunder ketij vendim lejohet ankim brenda 15 diteve nga dita e neserme e shpalljes ne Gjykatën Administrative te Apelit Tirane.
- U shpall në Tiranë, sot më datë 29/12/2014.

SEKRETARE

Qerime Boduri



GJYQTARE

Bernina KONDI



SHPENZIMET GJYQESORE

Takse padie	3 000 leke
Takse njoftimi	200 leke
Takse vendimi	200 leke
Shuma gjithsej	3 400 leke

